



Pranimi / Dorezimi Punësoni/Prototipi Received/Delivery	01.11.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPMSHCK	6817/2023		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1176/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktar-Kryetare, Arben Mehmeti, Ardita Haxhnikaj-Demi-Anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1176/2023 të datës 19.09.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted], me adresë: [redacted], kundër rezultatit përfundimtar të konkursit për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" në Komunë e Podujevës, në çështjen juridike, "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.11.2023, morri këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1176/2023, e datës 19.09.2023, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i

Komuna e Podujevës me datën 21.06.2023 ka shpallur konkursin për "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën e punës „Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve” i cili konkurs ka qenë i hapur nga data 12.07.2023 deri me datën 26.07.2023. Sipas listës së datës 28.07.2023 ankuesja ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, e njëjta ka vazhduar me testin me shkrim ku ka arritur 40 pikë në testin me shkrim ndërsa në vlerësimin e jetëshkrimit ka arrit 9.2 pikë duke ju pa mundur të vazhdojë në intervistën me gojë. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datën 14.09.2023 ka shpall njoftimin për kandidatet e suksesshëm.

Ankuesja pas publikimit të renditjes përfundimtare lidhur me konkursin për pozitën "Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve" në komunën e Podujevës, me datën 19.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim ankimore të bëhet anulimi i konkursit me numër reference RN000927.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Podujevës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 26.09.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 6145/2023 të datës 19.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e SIMBNJ lidhur me vlerësimin e testit me shkrim; Njoftimin e SIMBNJ lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit; Shkresën pa date të dërguar nga ankuesja në SIMBNJ; Emalin e SIMBNJ-së të pa date dhe numër; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.09.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 29.09.2023; Listën për kandidatin e përzgjedhur të datës 17.09.2023; Listën për kandidatin e përzgjedhur të datës 19.09.2023; Konkursin e datës 21.06.2023; Vendimin për themelimin e komisionit të datës 03.08.2023; Njoftimin e datës 28.07.2023; Aplikacionin e ankesës se bashku me shkresat e bashkangjitura; Diplomën universitare të datës 08.03.2021; Certifikatën e datës 18.07.2028; Certifikatën e datës 15.07.2019; Certifikatën e datës 10.07.2020; Dokumentin e identifikimit; Vërtetimin datës 16.05.2023; vërtetimin e datës 24.10.2019; Certifikatën e datës 10.10.2008; Vlerësimin e ankueses sipas SIMBNJ-së; Statusin e vlerësimit përfundimtar sipas SIMBNJ-së; Aplikacionin e kandidatës [redacted] se bashku me shkresat e bashkangjitura; Diplomën universitare të datës 27.07.2022; Certifikatën për pjesëmarrjen në trajnimin e soca soles; Certifikatën e pa date dhe numër; Marrëveshjen për realizimin e masës aktive të tregut; Certificate4n e datës 25.10.2019; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën e datës 26.07.2023; Aplikacionin e kandidatës [redacted] Diplomën e datës 08.02.2018; Kontratën e datës 03.02.2021 Kontraten e punës të datës 10.11.2021; Kontratën e Punës të datës 11.02.2022; Kontratën e punës të datës 30.03.2022 Marrëveshjen për angazhim të masës aktive të tregut të datës 03.10.2022; Letër referencën pa date dhe numër; vërtetimin e datës 24.08.2022; Letër referencën e datës 30.05.2023; CV; Dokumentin e identifikimit; Vlerësimin e Biografisë të datës 06.09.2023 të ankueses; Vlerësimet e datës 06.09.2023 të kandidatës [redacted] Vlerësimet e datës 06.09.2023 të kandidatës [redacted]

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e parakohshme, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Zyrtari i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës pas shpalljes së rezultateve për mes emalit ka njoftuar ankuesen se CV e juaj është në 10 (dhjetëshen) e pare, ndërsa e njëjta nuk është ftuar në intervistën me gojë, kështu që ankuesja i propozon këshillit të Pavarur Mbikëqyrës që ankesën e ankueses ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe anuloj konkursin e lartpërmendur.



Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës gjegjësisht konkursit me numër RN00011927, të datës 21.06.2023 për grupin " Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" me titullin e pozitës Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve , **kërkesë për pranim kanë qenë:** "Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët, Të jetë i aftë në pikëpanije shëndetësore për të kryere detyrën përkatëse. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji", ndërsa **kërkesat formale janë kërkuar:** Diploma e arsimit të lartë me se paku 3 vite të studimeve, Arsimit të lartë të paspecifikuar, Kualifikime të posaçme Certifikatën licencën ku kërkohet me legjislacion në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase, ndërsa nuk është kërkuar përvojë pune.

Bazuar në provat e administruara të lëndës, të dërguara nga ankuesja dhe institucioni, Kolegji konstaton se ankuesja me rastin e aplikimit përmes sistemit elektronik, ka kaluar fazën e verifikimit paraprak ndërsa e njëjta në testin me shkrim ka arritur gjithsejtë 40 pikë ndërsa në vlerësimin e jetëshkrimit ka arrit 9.2 pike e njëjta nuk ka arritur të vazhdojë në intervistën me gojë, tutje ankuesja me datë 19.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, duke mos i shterur mjetet e brendshme.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 25 paragrafët 4, 5, dhe 6, ku përcaktohet se: "...4.Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi ..përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit. 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrorë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje." si dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: 1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrorë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..." dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton se kandidatja e pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, fillimisht, duhet të ushtroj ankesë të brendshme të Komisioni i Pranimit, e me tej pas marrjes se vendimit të organit të punësimit apo në raste të heshtjes administrative, mund të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke respektuar afatet ligjor sipas nenit 127 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës rezulton se ankuesja me datë 19.09.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës, pa i shterur mjetet e brendshme. Andaj, nisur nga ky fakt, rrjedhë së ankesa e ankueses A.nr.1167/2023, e parashtruar me datë 19.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parakohshme, gjegjësisht Kolegji konstaton se ankesa e ankuesies është e palejueshme ngase nuk ka shteruar procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 25 paragrafin 4, 5, dhe 6, të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, respektivisht ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur






Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 16 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe, dhe si e tillë ankesa e ankueses është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A. nr.1176/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesja [REDACTED]
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

